



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 35 dt. 15.07.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 15.07.2014, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Projekti për ndërhyrje pjesore rehabilituese në Muzeun Historik Kombëtar”, Tiranë.
2. Miratimin e propozimit për shpalljen në mbrojtje paraprake, të disa objekteve në qytetin e Tiranës.
3. Lënie në fuqi të statusit monument kulture për objektin “Banesa e ish Institutit të Kulturës Popullore”, Rr Kavajës, Tiranë. (Shpallur monument kulture, kat II, me Vendim 122, dt. 05.03.2007).
4. Lënie në fuqi të statusit monument kulture për objektin “Banesa e Hysen Kazanit”, Tiranë. (Shpallur monument kulture me Vendim 1883, dt.1006.1973).
5. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

